



BASHKIA FIER



**TAKSAT DHE TARIEMAT VENDORE
2017**

I. TAKSAT VENDORE

1. Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin e Biznesit të Vogël.

A) Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e Biznesit të Vogël me qarkullim vjetor nga 0-5 milionë lek.

Çdo person fizik apo juridik, i cili kryen një veprimtari ekonomike (Biznes) me anën e të cilit realizohet qarkullim vjetor nga 0-5 milion lekë është i përjashtuar nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin.

- **Shkalla tatimore e aplikueshme 0.**

B) Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e Biznesit të Vogël me qarkullim vjetor nga 5-8 milionë lek.

- **Shkalla tatimore e aplikueshme 5%.**

Drejtoria Rajonale e Taksave dhe Tatimeve Fier llogarit, njofton dhe ndjek arkëtimin e detyrimit të Biznesit të Vogël për llogari të Administratës Vendore të Bashkisë Fier.

2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

A. Taksa mbi ndërtesën

- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen të gjitha familjet, personat juridik e fizik, vendas apo të huaj, të cilet janë pronare apo përdorues ndërtesash në territorin e administruar nga Bashkia Fier, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632 dt. 30.10.2006 “ Për Sistemin e Taksave Vendore”.
- Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.
- Baza e taksueshme është sipërfaqja e ndërtimit në m² e ndërtesës ose pjesës së saj mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat.
- Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit vërtetohet me dokumentin e pronësisë.
- Kontrata e qiradhënies shërben si dokument i vërtetimit të sipërfaqes së taksueshme.
- Subjekti taksapagues kur nuk disponon dokumentin e pronësisë, vetëdeklaron sipërfaqen e taksueshme, e cila brenda tre muajve duhet të verifikohet nga zyra e inspektimit ose të vërtetohet me dokumentin e pronësisë që ofron detyrimisht Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme dhe me akt-verifikimin përkatës.
- Taksa e ndërtesës llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit dhe paguhet për vitin kalendarik, duke filluar nga data e krijimit të saj (data e ndërtimit dhe regjistrimit të pasurisë) e në vazhdimësi, e llogaritur në njërën nga kategoritë e tabelës.

Kategoritë e ndërtesave dhe niveli i taksës për çdo kategori është sipas tabelës:

Nr.	Emërtimi taksës	Njësia	Taksa sipas ligjit	Taksa e Ndërtesës për Vitin 2017	
1	Ndërtesa Banimi	Lek/m ² /vit		Bashkia	Njesit.Adm.
	a) Ndërtuar para vitit 1993	“	10	10	5
	b) Ndërtuar pas vitit 1993	“	12	12	6
	c) Për Banesa të dyta	“	24	24	12
2	Ndërtesa për tregti dhe shërbime	Lek/m ² /vit		Bashkia	Njesit.Adm.
	a) Tregti, shërbime dhe profesione të lira	“	300	300	150
	b) Ndërtesa për depozitim (magazina)	“	300	270	135
	c) Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese	“	150	150	75
	d) Të tjera	“	60	60	30
3	Ndërtesa në pronësi apo përdorim në territore të miratuara për fshatra turistike	Lek/m ² /vit	400	360	360
4	Përrjashtohen nga pagesa për ndërtesat e banimit, familjet:				
	a) Me Ndhimë ekonomike			Po	
	b) Tetraplegjia, paraplegjik			Po	
	c) Të verbrit			Po	
	d) Invalid pune dhe të luftës			Po	
	e) Të përndjekurit politik			Po	
	f) Veteranët e luftës			Po	

Përrjashtimi bëhet kur përfituesi është **kryefamiljar** dhe e vërteton statusin me dokument ligjor. Përrjashtimi bëhet vetëm për një rast.

Pagesa e taksës se ndërtesës

Taksa për ndërtesat e banimit arkëtohet nga Ndermarrja Ujësjiellës-Kanalizime Fier ndërsa për rastet kur nuk ka kontratë me NUK Fier do të arkëtohet pranë Rajoneve dhe Njërive Administrative së bashku me taksat e tarifat e tjera për çdo familje.

Taksa për ndërtesat e tjera arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave.

Shënim I: Tatimpaguesit që kanë në pronësi më shumë se një banesë, për shtëpinë ku kanë banimin e zakonshëm paguajnë taksën e ndërtesës, sipas seksionit I-re të tabelës, ndërsa për të gjitha shtëpitë e tjera, taksa e ndërtesës është sa dyfishi i taksës së ndërtesës, që zbatohet në zonën ku ndodhet kjo ndërtesë.

Shënim II: Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pa shitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës. Ambiente të hipotekuara si:

- apartamente banimi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “Ndërtesa banimi”.
- ndërtesë biznesi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “Ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime”.

B. TAKSA PER TOKEN BUJQESORE

Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor dhe paguhet brenda vitit fiskal. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në hektarë, në pronësi/perdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Nr	Klasifikimi sipas kategorisë se tokës Sipas Ligjit	Lekë/hektar/vit Sipas Ligjit	Taksa për vitin 2017
1	I	5600	3920
2	II	4900	3430
3	III	4200	2940
4	IV	3600	2520
5	V	3000	2100
6	VI	2400	1680
7	VI deri X	1800	1260

Per Taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore, jepet lehtësim ose përjashtimi i përkohshëm .Kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar, deri në vlerën 75 për qind.

Për vitin 2017 zbatohet ulja **30 %** e nivelit tregues te taksës.

C. TAKSA MBI TRUALLIN

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

Kategoritë e taksës se truallit	Niveli tregues i taksës se truallit
a) Për qëllime banimi nga individ	0.56 lek/m ² /vit
b) Për qëllime biznesi	20 lek/m ² /vit

Në piken a) Përjashtohen të gjitha kategoritë që janë përjashtuar të taksa e ndërtesave të banimit.

Ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave për vjeljen e saj.

3. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË

- Niveli i taksës ndikimit në infrastrukturë përcaktohet sipas ligjit nr. 9632 dt. 30/10/2006 me ndryshime “Për Sistemin e Taksave Vendore “.
- Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet.

Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

- Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është 1 deri në 3 për qind të kësaj vlere.
- Detyrimi për taksën i takon investitorit.
- Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një njësie vendore ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një njësie tjetër vendore, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës njësi.
- Kur objekti sipas projektit, ka disa nga kategoritë e cituara në tabele, llogaritjet e taksës bëhen për vlerat respektive të secilës kategori.
- Ngarkohet **Drejtoria e Urbanistikës** për llogaritjen, arkëtimin dhe dokumentimin e Taksës së Ndikimit në Infrastrukture.

Nr	Kategoritë/Nën kategoritë	Taksa e ndikimit në infrastrukturë Zonat			Njësitë Admin.
		A %	B %	C %	D %
1	Objekte për qëllime banimi dhe shërbimi individuale, me vlerën e investimit / m2				
	a) 1 kat	1.5	1.5	1	1
	b) 2 kat - 3 kat	2	1.5	1.5	1
	c) 4 kat – 6 kat	2.5	2	2	1
	d) Objekte për qëllime shërbimi	3	3	2.5	2
2	Objekte për qëllime banimi dhe shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, me çmimin e shitjes / m2				
	a) 1 kat	4	4	4	4
	b) 2 kat - 3 kat	4	4	4	4
	c) 4 kat – 6 kat	4	4	4	4
	d) mbi 6 kat	4	4	4	4
	e) Objekte për qëllime shërbimi	4	4	4	4
3	Ndërtime me objekt prodhimi				
	a) Ndërtime me funksion prodhimi përpunim të produkteve bujqësore dhe blegtorale	1	1	1	1
	b) Ndërtime me funksion prodhimi industrial	2	2	2	2
4	Objekte me përdorim publik	2	2	2	1
5	Institucione Fetare, bamirësie, etj. të ngjashme	1.5	1.5	1.5	1
6	Objekt për përdorim në sektorin e turizmit (me vlerën e investimi)	1	1	1	1
7	Leje zhvillimore Infrastrukture ujësjellës, kanalizime, rrugë kombëtare etj	0.1	0.1	0.1	0.1
8	Për ndërtesat të cilat janë në proces legalizimi	0.5	0.5	0.5	0.5

Përrjashtimisht për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në

energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar.

4. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË

- Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Kategoritë e ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepet në tabelën e mëposhtme. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
- Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
- Vjelja e kësaj takse bëhet nga **Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)**, të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar.

Niveli i taksës sipas ligjit nr.9632 dt.30.10.2006, me ndryshime, është si më poshtë:

Nr.	Kategoritë / Nënkatëgoritë	Niveli i taksës Lekë/ m2
1.	Ndërtesa banimi	300
2.	Ndërtesa të tjera për tregti e shërbime	700
3.	Ndërtesa të tjera	500

5. TAKSA E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE

- Taksa llogaritet sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9975 dt. 28.07.2008 të ndryshuar “Për taksat kombëtare” dhe Udhëzimit të MF nr. 18 dt. 23.08.2011.
- Drejtoritë Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin, brenda datës 30 të çdo muaji, për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njësjive të qeverisjes vendore.

- Drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njësive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit.
- Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të faturës për arkëtim, 18 % të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit ku është njësia e qeverisjes vendore.
- Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

6. TAKSA E REKLAMËS

- Reklame do të konsiderohet tabela e thjeshtë apo elektronike e vendosur për qëllime reklamimi të aktivitetit, emrit të mire apo mallit.
- Baza e taksueshme është sipërfaqja në m².
- Drejtoria e Urbanistikes, mbasi shqyrton kërkesën e subjektit, jep lejen për vendosjen e Reklamës.
- Në lejen e lëshuar nga Drejtoria e Urbanistikes, përveç të tjerave, detyrimisht përcaktohen vendi i vendosjes, lloji i reklamës, sipërfaqja. etj. Një kopje e lejes se lëshuar i përcillet Drejtorisë së Taksave.
- Drejtoria e Taksave llogaritë e arkëton taksën e reklamës për vitin kalendarik nga data e vendosjes së saj, sipas përcaktimeve në lejen e lëshuar nga Urbanistika.

Kategoritë e bazës dhe niveli i taksës së reklamës është si më poshtë:

Kategoritë	Niveli i Taksës
Tabela për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme	
a) Tabelë e thjeshtë	22.500 leke/m ² /vit
b) Tabelë elektronike	45.0 leke/m ² /vit

7.TAKSA E FJETJES NË HOTEL

- Me “hotel” kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.
- Hotele ndahen në kategori: Hotele me 4-5 yje dhe motele, bujtina, fjetore, stabilimente turistike dhe çdo njësi tjetër akomoduese sipas përcaktimit të ligjit për turizmin (llogaritja e taksës paraqitet në tabelën më poshtë).
- Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili, mbahet nga hoteli për llogari të Bashkisë Fier dhe derdhet në favor të Bashkisë brenda datës 5 të muajit pasardhës.

- Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Ngarkohet **Drejtoria e Taksave dhe Tarifave** për arkëtimin e kësaj takse.

Kategoritë	Niveli i taksës
Hotel 4-5 yje	175 lekë/natë
Bujtinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese	70 lekeë/natë

II. TARIFAT VENDORE

1. Tarifa e Shërbimit për Komunitetin

- Tarifat paguhen nga çdo familje e regjistruar në regjistrin e gjendjes civile.
 - o Detyrimi i tarifës është vjetor dhe paguhet për vitin kalendarik .
- Për çdo familje të re, të regjistruar gjatë vitit detyrimi arkëtohet brenda 30 ditë nga data e regjistrimit dhe ai llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit.
- Arkëtimi behet pranë arkës së rajonit së bashku me detyrimet e tjera brenda datës 30 qershor.
- Familjaret pajisen me certifikatë (format) të arkëtimin të taksave e tarifave.

Nr.	Emërtimi tarifës	Njësia matëse	Tarifa për vitin 2017	Njësit Adm.
1	Tarifa Shërbimi (pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi)	Lek/familje/vit	2400	1200
2	Përrjashtohen nga pagesa familjet			
	a) Me Ndihme ekonomike		Po	Po
	b) Tetraplegjik, paraplegjik		Po	Po
	d) Invalid punë dhe të luftës		Po	Po
	e) Të përndjekurit politik		Po	Po
	f) Veteranët e luftës		Po	Po

Përrjashtimi behet kur përfituesi është **kryefamiljar** dhe e vërteton statusin me dokument ligjor. Përrjashtimi behet vetëm për një rast.

Nuk përfitojnë nga ky përrjashtim familjet kur kryefamiljari ka biznes. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës së pastrimit do të jetë Drejtoria e Tatim Taksave, në Bashkinë Fier.

2. Tarifat e Pastrimit për Biznesin

2.a).Tarifa e Pastrimit për Biznesin e Vogël

Biznes i vogël konsiderohen të gjithë personat fizik apo juridik që realizojnë një qarkullim vjetor deri në 8 milion lekë. Kategoritë e nënkategoritë e biznesit dhe niveli përkates i tarifës janë si më poshtë:

Nr.	Kategoritë e nënkategoritë e biznesit	Njësia matëse	Niveli i Tarifës	
			Bashkia	Njësit Administr.
1	Për çdo njësi tregtimi:	lek	10 000	5 000
	Nga këto: Biznes i Vogël me TVSH	lek	20 000	15 000
	Përveç rasteve cituar me poshtë			
	1.1 Për tregtim bulmet, mish, peshk	lek	15 000	8 000
	1.2 Për Restorante, Bufe, Kafënë, Piceri, pastičeri			
	a) me sipërfaqe deri 100 m2	lek	15 000	8000
	b) me sipërfaqe mbi 100 m2	lek	20 000	15000
2	Për çdo njësi shërbimi			
	a)Riparime elektro shtëpiake, rrobaqepës, berber etj	lek	5 000	3 000
	b) Servis automjetesh	lek	10 000	10 000
3	Për çdo njësi Prodhimi			
	a) Veprimtaria Biznes i Vogël	lek	15 000	5 000
	b) Veprimtaria Biznesi i Vogël me TVSH	lek	20 000	15 000
4	Për çdo njësi profesione të lira	lek	5 000	3 000
	a) Noter, avokat, arkitekt, ekspert të gjitha fushave Përkthyes,inxhinier, etj. të ngjashëm	lek	10 000	5 000
	b) Stomatolog, mjek, mjekut laborant, farmacist etj.	lek	10 000	8 000
5	Për çdo njësi të lojërave të fatit:			
6	Bilardo	lek		
	a) Deri në 2 fusha	lek	5 000	1 000
	b) 3 deri në 5 fusha	lek	10 000	3 000
	c) Mbi 5 fusha	lek	20 000	10 000
7	Internet , lojëra elektronike për fëmijë	lek	10 000	5 000
8	Agjenci të ndryshme:	lek		
	a) Person fizik	lek	10 000	8 000
	b) person fizik apo juridik me TVSh	lek	20 000	10 000
9	Klinik Dentare, mjekësore, laborator dentar ose depo farmaceutike:			
	a) Biznes i vogël	lek	20 000	8 000
	b) Biznes i vogël me TVSH	lek	50 000	20 000
10	Për kopshte, çerdhe, jo publike	lek	10 000	5 000
11	Për shkolla jo publike (Për çdo klase)	lek/klasë	2 000	2 000
12	Institucionet privatë, komplekse sportive, ekspozita, polici private, autoshkolla, etj. Të ngjashme	lek	20 000	10 000
13	Hotele, motele (për çdo dhomë)	lek/dhomë	2 000	1 500
14	Për çdo parking privat dhe lavazh	lek	15 000	8 000
15	Për çdo ambulant	lek	2 000	1 000
16	Institucione dhe organizata jo qeveritare:	lek	5 000	3 000
17	c) Veprimtaria biznesi i vogël me tatim fitimi	lek	25 000	20 000

Në rast se një person juridik ose fizik me T.V.SH. ushtron aktivitet në disa njësi, brenda territorit të Bashkisë, zbatohen tarifat dhe taksat e Biznesit të Vogël. Kur veprimtaria është njësi e rretheve të tjerë do të zbatohen taksat dhe tarifat e vendosura për persona juridike. Kur ka me shume se një njësi, për ato njësi zbatohen taksat dhe tarifat e Biznesit të Vogël. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës se pastrimit do të jetë Drejtoria e Tatim Taksave.

2.b).Tarifa e Pastrimit për Biznesin e Madh

Biznes i madh, konsiderohen të gjithë personat fizik apo juridik që realizojnë një qarkullim vjetor mbi 8 milion lekë dhe pavarësisht nga kjo, janë objekt i Tatimit mbi Fitimin.

Kategoritë e nënkategoritë e biznesit dhe niveli i tarifës së pastrimit, janë si më poshtë:

Nr.	Kategoritë e nënkategoritë e biznesit	Njësia matëse	Bashkia
1	Aktivitet biznesi i madh të shitjes me pakicë e shumicë, përveç rasteve si më poshte:	Lek /Vit	50 000
a)	Bar-restorante, disko, pube, diskoteka	"	70 000
	a/1 - Për çdo filial apo njësi të tyre	"	20 000
b)	Tregtim Lëndë djegëse, karburant, gaz	"	80 000
	b/1 - Për çdo filial apo njësi	"	60 000
c)	Tregtim materiale ndërtimi, tulla, tjegulla, dërrase, çimento, gëlqere, blloqe betoni, etj.të ngjashme	"	80 000
	c/1 - Për çdo filial apo njësi	"	50 000
d)	Tregje Privatë	"	70 000
	d/1 - Për çdo filial apo njësi	"	50 000
e)	Lojëra fati: Eurolloto, kazino, ruletë, etj. të ngjashme	"	70 000
1/1	Njësi apo filiale të biznesit të madh me aktivitet shitje përveç rasteve të cituara më poshtë:	lek/vit	15 000
a)	Njësi tregtim me shumicë	"	20 000
b)	Supermaketë, etj. të ngjashme	"	50 000
c)	Sallone ekspozimi shitje	"	25 000
d)	Sallone: eurolloto, kazinoje, etj. të ngjashme	"	70 000
2	Aktiviteti biznes i madh prodhues, përveç rasteve cituar më poshtë	lek/vit	50 000
a)	Prodhim buke	"	40 000
b)	Prodhim materiale ndërtimi, tulla , tjegulla, çimento,etj.	"	80 000
	b/1 - Për çdo filial apo njësi	"	50 000
c)	Prodhim përpunim naftë, e nënprodukte të tyre	"	350 000
d)	Impiante për therje bagëtish (thertore)	"	60 000
e)	Komplekse të rritjes e therjes për shpend, derra, gjedh,etj.	"	100 000
2/1	Njësi apo filiale të biznesit të madh prodhues	"	20 000
3	Aktivitet Shërbimi Biznes i Madh Përveç rasteve më poshtë	"	50 000
a)	Banka privatë e filiale të tyre	"	60 000
b)	Televizionet privatë edhe radiot	"	5 000
c)	Shërbimi spitalor (Spitale), diagnostikimi, kurimi Shtetëror apo privat	"	100 000
	c/1 - Për çdo filial apo njësi	"	40 000
d)	Klinika mjekësore, laborator diagnostikimi, farmaci , etj. të ngjashme	"	60 000
	d/1 - Për çdo filial apo njësi	"	30 000

Nr.	Kategoritë e nënkategoritë e biznesit	Njësia matëse	Bashkia
e)	Për Institucion arsimor jo publik, universitet, shkolla		70 000
	e/1 Filiale apo njësi të tyre		20 000
f)	Agjenci sigurimesh, këmbim valutor,transporti, etj.		40 000
	f/1 Për çdo filial apo njësi		20 000
g)	Për autoshkolla, polici privatë, kurse kualifikimi, etj.		30 000
h)	Ndërmarrjet (SHA apo SHPK) të shërbimit për energji elektrike e telefonisë fikse		100 000
3/1	Për çdo njësi apo filial shërbimi të biznesit të madh		10 000
4	Biznes i Madh me aktivitet profesione të lira		30 000
5	Institucione shtetërore		50 000
6	Ndërmarrje shtatore		50 000
7	Biznesi i Madh me aktivitet ndërtimi		70 000
7/1	Për çdo kantier, me leje ndërtimi - zhvillimi në raport me kohëzgjatjen e përfundimit të ndërtimit dhe vlerën e tij deri në marrjen e certifikatës së përdorimit		
	Vlera e Investimit në 000/Lek		
	a)	Deri në 5,000	15 000
	b)	5,000 - 15,000	30 000
	c)	15,000 - 30,000	45 000
	d)	30,000 - 50,000	60 000
	e)	50,000 - 100,000	80 000
	f)	100.000 - 500,000	100 000
	g)	Mbi 500.000	500 000
8	Biznes me aktivitet nxjerrje edhe përpunim hidrokarburesh me seli dhe filialet brenda territorit të Bashkisë		
	a)	Me prodhim deri në 100.000 tonë	12 000 000
	b)	Me prodhim mbi 100.000 tonë	24 000 000

Niveli i tarifave është detyrim vjetor dhe llogaritet për vitin kalendarik.

Kur biznesi krijohet apo mbyllet gjatë vitit kalendarik detyrimi do të llogaritet:

- Tarifa për biznesit e reja llogaritet nga data e regjistrimit të tij në QKB.
- Kur mbyllet aktiviteti, pagesa llogaritet dhe arkëtohet proporcionalisht me kohën që ka qënë aktiv.

Për Kategorinë pika 7/1 Me Objekt “Kantierë Ndërtimi”

- Tarifa për çdo kantier llogaritet dhe arkëtohet nga zyra e Urbanistikes
- Arkëtimi realizohet me të njëjtën procedure si taksa e ndikimit në infrastrukture, me emërtimin “ Tarifë Pastrimi “ .
- Arkëtimi kryhet brenda datës 31 dhjetor, për çdo vit/kantier të llogaritur
- Kohëzgjatja e kantierit, për efekt të llogaritjes e arkëtimit se tarifës, është nga momenti i fillimit të punimeve deri në dorëzimin e kërkesës nga subjekti për leje shfrytëzimi

3. Tarifa e Shërbimit për Biznesin

Nr.	Kategoritë/Nënkategoritë	Bashkia	Njësit Admin.
1	Për çdo subjekt të biznesit të madh	7 000	3 000
1.1	Njësi apo filiale të tyre	5 000	2 000
2	Për biznesin e vogël: Çdo njësi tregtimi, prodhimi, shërbimi, etj.	3 000	1 000
3	Për biznesin e vogël me TVSH	5 000	2 000
4	Ndërmarrje e institucione shtatore	7 000	3 000

- Niveli i tarifave është detyrim vjetor dhe llogaritet për vitin kalendarik.
- Kur biznesi krijohet apo mbyllet gjatë vitit kalendarik detyrimi do të llogaritet proporcionalisht, sipas numrit të ditëve që subjekti ka qenë aktiv.
- Tarifa llogaritet dhe arkëtohet, nga Drejtoria e Taksave brenda datës 30 Prill.

4. Tarifa për Mjetet e Transportit

4.a) Tarifat e Shërbimit dhe tarifa për tonazh

Nr	Kategoritë/Nënkategoritë	Për vitin 2017	
		Bashki	Njësi Admin.
1	Tarifa e Shërbimit (pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi) për çdo mjet transporti	7 000	3 500

4.b) Tarifa e Parkimit- abone

- Parkimi abone i jepet subjektit fizik apo juridik vetëm me Leje për parkim abone të lëshuar nga Drejtoria e Transportit. Në lejen e lëshuar përcaktohet nr. i vendparkimeve dhe vendndodhja e tyre.
- b. Leja për vendparkim abone jepet në përputhje me dispozitat e qarkullimit rrugor.
- c. Arkëtimi i Tarifës për vendparkim abone behet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave sipas përcaktimeve në lejen e lëshuar për subjektin.

Nr	Kategoritë/Nënkategoritë	Për vitin 2017	
		Bashki	Njësi Adminis.
1	Për çdo vend parkimi autovetura 4 + 1 dhe 8 + 1	20 000	5 000
2	Për çdo vend parkimi autobus apo kamion	37 000	10 000

4.c) Tarifa e parkimit për çdo mjet transporti për persona fizik ose juridik

Nr	Kategoritë e mjeteve sipas Kodit Rrugor	Treguesit e Mjeteve		Tarifa Parkimit
		Nr. Vende	Ngarkesa në Ton	Lek/Vit
1	Autovetura (privatë apo shtetërore)			1 000
2	Taksi	1 + 4		5 000
3	Taksi	1 + 8		8 000
4	Autobuza	9 - 30		10 000
5	Autobuza	30 - 50		11 000
6	Kamion		1.5 - 3.5	3 000
7	Kamion		3.6 - 8	5 000
8	Kamion		8.1 - 14	6 000
9	Kamion		14.1 +	8 000
10	Tërheqës (Kok Tërheqëse)		7.5 ton	5 000
11	Rimorkio		1 - 16	6 000
12	Trailer		16 - 40	8 000
13	Rimorkio e makineri të renda		40 - 100	10 000
14	Autovinxha		1 - 14	5 000
15	Autovinxha		14.1 - 100	8 000
16	Makineri Ngarkimi			5 000
17	Autobetoniere			10 000
18	Autopompa betoni			12 000

Tarifat për mjetet janë vjetore . Ato llogariten dhe arkëtohen nga drejtoria e taksave brenda datës 20 prill për mjetet që janë në punë (dhe në vazhdimësi gjatë vitit për mjetet që regjistrohen rishtas)

Në rastet kur periudha respektive është më pak se një vit (rastet kur certifikata e mjetit nuk duhet të tejkalojë afatin e licencës) , tarifa llogaritet proporcionalisht, me periudhën disa mujore.

Arkëtimi Tarifave të transportit

- Arkëtohen për çdo mjet transporti në inventar të subjektit fizik apo juridik, për aktivitetin e tyre biznes i madh apo i vogël qe pajiset me leje transporti nga Drejtoria e Transportit.
- Shoqëritë e Transportit të udhëtareve(SHPK), **me aktivitet të regjistruar në QKR vetëm Transport udhëtaresh** , arkëtojnë Tarifat për çdo mjet në inventar dhe nuk arkëtojnë tarifat si subjekt SHPK. Kur në dokumentet e regjistrimit kanë dhe aktivitet tjetër paguajnë edhe tarifat si subjekt i biznesit të madh.
- Drejtoria e Transportit nuk jep leje transporti pa arkëtuar tarifat për çdo mjet.
- Struktura për arkëtimin e tarifave është Drejtoria e Transportit dhe Drejtoria e Taksave.

4.d) Tarifat për leje e certifikata transporti dhe autorizime karburanti, lende djegëse, bombola gazi

Nr	Tarifat e licencimit të Transportit të Udhëtareve	Njsia	Tarifa
1	Licencë për transport udhëtaresh në linje të rregullt qytetëse	Lek/5 vjet	40 000
2	Certifikatë për transport udhëtaresh në linje të rregullt qytetëse	Lekë/mjet/Vit	5 000
3	Licencë për transport udhëtaresh në linje të rregullt rrethqytetëse	Lekë/ 5 vjet	20 000
4	Certifikatë për transport udhëtaresh në linje të rregullt rrethqytetëse	Lekë/mjet/Vit	1 500
5	Licencë për transport udhëtaresh në linje të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	Lekë/ 5 vjet	75 000
6	Certifikatë për transport udhëtaresh në linje të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	Lekë/mjet/Vit	1 500
7	Licencë për transport udhëtaresh në linje të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	Lekë/ 5 vjet	75 000
8	Certifikatë për transport udhëtaresh në linje të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	Lekë/mjet/Vit	1 500
9	Licencë për agjenci transporti udhëtaresh dhe taksi brenda vendit	Lekë/ 5 vjet	15 000
10	Licencë për agjenci ndërkombëtare udhëtaresh	Lekë/ 5 vjet	40 000
11	Licencë për transport udhëtaresh me taksi	Lekë/mjet/5vjet	20 000
Tarifa Licencimit të Transportit të mallrave			
1	Licencë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit	Lekë/ vit	8 000
2	Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit	Lekë/Kapacitet	100
3	Certifikatë për transport mallrash për vete brenda vendit	Lekë/Kapacitet	100
Autorizime Karburanti/Lende djegëse/Bombola Gazi			
1	Licencë Karburanti / Lende djegëse	Lekë/5vjet Rinovimi	2 000 000 2 000 000
2	Autorizim për njësit e shitjes lende djegëse dhe Bombolave të gazit	Lekë/5vjet Rinovim	200 000 200 000

- Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie, paguhet 30% e vlerës së plotë të tarifës.
- Për rastet e ndryshimeve në licencë/certifikatë që kanë të bëjnë me elementët e përdoruesit të mjetit, fushës së operimit, etj, paguhet 30% e vlerës së plotë të tarifës.
- Licensat model 109 për transport malli, për të tretët me qera, do të jepen për një afat 1 vjeçar.
- Tarifa e shërbimit për licensë, certifikatë ose autorizim në fushën e transportit 500 Lek.

- Tarifat e licencave dhe certifikatave përgatiten, llogariten dhe arkëtohen nga Drejtoria e Transportit dhe Licencave Profesionale.

5. Tarifa për dhënie leje ushtrim aktiviteti

- Objekt i kesaj tarife, janë ato aktivitete për të cilat detyrimisht duhet të plotësohen disa kushte përpara se ato të ushtrojnë aktivitetin.
- Lejet jepen nga Bashkia (drejtoritë të cilat mbulojnë aktivitetin respektiv), mbasi të jetë kontrolluar zbatimi i kushteve të paracaktuara.
- Tarifa llogaritet nga struktura (Drejtoria) qe pajis me leje personin fizik/juridik, në momentin e dhënies se lejes, sipas tabelës me poshtë.

Nr	Kategoritë / Nënkategoritë	Niveli Tarifës në Lek
1	Për Servis automjetesh, lavazho, parking privat	10 000
2	Për aktivitet tregje privatë	10 000
3	Për aktivitet shërbim funeral	10 000
4	Për Disko, Pube, etj. të kësaj natyre qe krijojnë zhurma	10 000
5	Ushtrim aktiviteti me orar të zgjatur por të kufizuar	5 000
6	Ushtrim aktiviteti non stop 24 ore	10 000
7	Organizim Cirqe, panaiere, spektakle, etj në hapësira publike	3 000

Arkëtimi i tarifës behet nga drejtoria e Taksave dhe Tarifave, në Bashkinë Fier.

6.Tarifat për shërbimet veterinarë

Nr	Kategoritë/ Nënkategoritë	Njësia	Tarifa Lek
1	Për kontrollin e pajisjen me certifikatë të mishit në thertore të miratuara		
	a) Për bagëti të trash	lek/krerë	200
	b) Për bagëti të imta	lek/krerë	50
	c) Për Derra	lek/krerë	100
	d) Për Shpend	lek/krerë	5
2	Për kontrollin e pajisjen me certifikatë të mishit në Komplekset e rritjes dhe therjes se kafshëve		
	a) Për Pula dhe zogj	lek/krerë	2
	b) Për pula dhe gjela deti	lek/krerë	3
	c) Për Derra	lek/krerë	50

Tarifat per sherbimet veterinarë arkëtohen nga Drejtoria e Inspektoratit Veterinar të Bashkisë Fier.

7. Tarifat për shërbime administrative

Nr.	Kategoritë/nënkategoritë	Tarifa në lekë
1.	Për Shërbimin Arkivor: - Tërheqje dokumentesh, njësimë me origjinalin dhe vërtetime/për fletë	10
2.	Për shërbime nga të gjitha drejtoritë dhe zyrat e Bashkisë - Lëshim vërtetime e dublikatë dokumenti, etj. të ngjashme	100
3.	Për shërbime në Rajonet (Njësitë Administrative) - Vërtetim identiteti , për hipotekim të pasurisë se paluajtshme - Të gjitha vërtetimet e tjera	200 100

Arkëtimet e ketyre tarifave bëhen në arkën e Bashkisë dhe/ose Rajoneve para kryerjes së shërbimit.

8.Tarifa për Shërbime Urbanistike

Nr	Emertimi i Tarifës	Niveli i Tarifës në Lek
1	Tarifë Aplikimi për leje punimesh për persona	
	a) Fizik	1 000
	b) Juridik	5 000
2	Tarifa për Aktkontrollet	
	a) Kontroll i piketimit të objektit	1 500
	b) Kontroll i përfundimit të themeleve	1 500
	c) Kontroll i përfundimit të karabinasë	1 000
	d) Kontrolli i përfundimit të objektit	5 000
	e) Kontrolli i sistemimit të objektit	1 500
3	Tarifa e fotokopjimit të plansheteve	
	a) Format A4	200
	b) Format A3	300
	c) Format A2	400
	d) Format A1	600
	e) Format A0	1 000
	f) Fotokopje e doku. Të nxjerr nga arkivi (për fletë)	300
4	Tarifë dhënie Gentplani të pa azhurnuar	
	a) Format A4	1 500
	b) Format A3	5 000
5	Tarifë fotokopje të dok. të dosjes njësim me origjinalin (kerkesë e organeve të drejtësisë)	5 000
6	Përgatitja dhe përcjellja e dokumentacionit të fitimit të pronësisë, të fituara me aktin e tokës në pronësi për në ZVRPP Fier	2 000
7	Kërkesë e përsëritur e dokumentacionit tekniko ligjor të dosjeve të lejeve të ndërtimit për në ZVRPP	2 000
8	Tarifë për deklaratë për kryerje punimesh	
	- për personat fizik	2 000
	- për personat juridik	5 000
9	Leje për ndërhyrje të ndryshme	
	a) Leje për prerje peme	1 000
	b) Leje për hapje kanali në rruge	3 000

Tarifa e Zënies së Hapësirës Publike

- Kjo Tarifë paguhet për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi.
- Tarifa llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit (sipas nivelit në tabelën më poshtë).
- Tarifa për zënien e hapësirës publike nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor.

Kategoria	Niveli i Tarifës për Bashkinë	Niveli i tarifës për Njësitë Administrative
Zënie e Hapësirës Publike	500 lek/m ² /muaj	200 lek/m ² /muaj

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave ne Bashkinë Fier është përgjegjëse për ndjekjen dhe arkëtimin e Tarifës për Zënien e Hapësirës Publike.

10. Tarifa e përkohshme për mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e shkollave

Emërtimi	Vlera/lekë/familje
Tarife e përkohshme mirëmbajtje/rikonstruksion shkolle	600

Përfshihen nga kjo tarifë, kategoritë e familjeve që janë të përjashtuar nga taksat dhe tarifat, si dhe familjet që në përbërjen e tyre kanë vetëm pensionistë

11. Garanci për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e librit nga anëtarët e Bibliotekës Publike.

Emërtimi	Vlera/leke/person
Garanci libri	1 000

Afati i pagesës së detyrimeve tatimore vendore është data 20 Prill edhe kësti i dytë i taksës së ndërtesës është deri në 30 Shtator 2017.

Baza Ligjore

Ligji Nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.

Ligji Nr. 9632 dt. 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me ndryshime, dhe Udhëzimi 32 dt. 31.12.2013 në zbatim të tij.

Ligji Nr. 9920 dt 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” dhe Udhëzimi Nr. 24 dt. 02.09.2008 në zbatim të tij, me ndryshime.

Vendimi i Këshillit Bashkiak

Për çdo informacion plotësues, mos hezitoni të drejtoheni në:

Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Fier.

<http://www.fier.gov.al/>



Kjo broshurë u bë e mundur me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. Ajo u përgatit nga Projekti i USAID-it për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore.